



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:145699

Datë: 03.07.2023

Numri i dokumentit: 04497975

K.nr.1024/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ, në përbërje të gjyqtarit individual Bahri Salihu, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Igballe Arifi, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Argjend Fazliu-pranor i operatorit ekonomik “ RD LINDI PETROL” , njësia punuese në fsh. Davidovc, Komuna Shtime, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 të Ligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Larburanteve të Ripërtërishme (Ligji nr.08/L-018), sanksionuar sipas nenit 19 par. 13 të të njëjtit ligj dhe nenit 26 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit (Ligji nr.06/L-034), sanksionuar me nenin 137 të të njëjtit ligj, në bazë të neneve 55,77,86,119,124 dhe 127 të Ligjit për Kundërvajtje nr. 05/L-087, më datë 03.07.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Argjend Fazliu - pronar i subjektit ekonomik “ RD Lindi Petroll “, Njësia Punuese në fsh. Davidovc, Komuna Shtime, me NR. të regjistrimit të Biznesit 811581215, i lindur me dt.22.08.1991 në fsh. Carralevë, Komuna Shtime, me vendbanim në Lipjan, rruga” Mbreti Zog” , p.n. , shtetas i Republikës së Kosovës, shqiptar, i martuar-prind i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme , i gjendjes së mesme ekonomike

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse më dt.28.06.2022, në kohë të pa përcaktuar, gjatë inspektimit të kryer nga ana e inpektorëve të Tregut të MINT-së, në bashkëpunim me inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës tek operatori ekonomik “ RD Lindi Petrol” – Njësia Punuese në fsh. Davidovc, lidhur me verifikimin e çmimit maksimal të lejuar për secilin produkt të naftës të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2022 për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat tjera Mbrojtëse, është konstatuar se i pandehuri ka tejkaluar çmimin maksimal të lejuar për product benzine sipas njoftimit ditor – 24 orë, ku çmimi maksimal i lejuar ka qenë 1,74 euro, ndërkaq shitja për produktin e benzinës është realizuar për çmimin prej 1,79 euro

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 15 të Ligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme (Ligji nr.08/L-018), sanksionuar sipas nenit 19 par. 13 të të njëjtit ligj dhe nenit 26 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit (Ligji nr.06/L-034), sanksionuar me nenin 137 të të njëjtit ligj

- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore, në mbështetje të nenit 35 të Ligjit për Kundërvajtje

D Ë N O H E T

ME DËNIM NË TË HOLLA në shumën prej 1.500,00 € (Njëmijë e Pesëqind euro).

Dënimin e shqiptuar në të holla ka për t’a paguar në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale (paushallit gjyqësor) të paguaj shumën prej 10,00/- € (dhjetë euro) në afatin e njëjtë sikurse dënimin në të holla në kuptim të nenit 59 dhe 76 të Ligjit për Kundërvajtje.

Nga një ekzemplar i këtij aktgjykimi iu dërgohet palëve.

Arsyetimi

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -Inspektoriati i Tregut në Prishtinë, kësaj gjykate i ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse me nr. të protokollit 4182-19, me nr. të Ref. 19/22 të datës 01.07.2022, kundër të pandehurit Argjend Fazliu-pronar i “ RD Lindi Petrol” për shkak të kundërvajtjes së përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilën ka kërkuar që të zhvillohet procedura kundërvajtëse dhe që pas administrimit të provave i pandehuri të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin, i cili në deklaratën e tij ka pranuar fajsinë në tërësi për veprën kundërvajtëse me të cilën është ngarkuar ashtu siç përshkruhet në kërkesë. Njëherit, ka theksuar se kjo më ka ndodhur për shkak të pa përgjegjësisë së punëtorëve, përkatësisht të ndërrimit të punëtorëve që bëhet çdo herë në të njëjtën kohë për çdo ditë, me që nëse ndërrimi i punëtorëve bëhet në ora 14,00, ashtu që ata e kanë pasur më lehtë mos me pranuar kërkesën time për të ndërruar çmimin, përkatësisht për t'u mos barazuar dy herë brenda ndërrimit duke llogaritur që shitja e karburantit benzinë është më e ulët në pikën përkatëse. D.m.th., se brenda 24 orëve të asaj dite, kanë qenë të shitura 34,53 litragjë që të lë me kuptuar se brenda urdhërit të dhënë dhe zbatimit të urdhërit, ka pasë mundësi që të mos shitet asnjë litër. Duke llogaritur realizimin e shitjes një vjeqare, rezulton që subjekti ekonomik që unë e drejtoj, gjatë tërë vitit ka bërë shitje në shumë prej 455 mijë euro, çka do të thotë se për krejt vitin, shitja e benzinës nuk arrinë as 10 %.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, deklaratës së të pandehurit dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari arriti në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formësuar të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për çka dhe u shpall fajtor dhe u denua siç u cek më lart.

Me rastin e marrjes së vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit gjyqtari mori parasysh rrethanat e parapara me nenin 31 dhe 35 të Ligjit për Kundërvajtje dhe atë peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, shkallën e përgjegjësisë, rrethanat nën të cilat është kryer vepra

kundërvajtëse, gjendjen e tij personale dhe pasurore dhe tiparet personale të tij dhe si rrethanë lehtësuese është vlerësuar pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, pendimi dhe premtimi se nuk do t'a përsëris më një vepër të tillë, ndërkaq rethana rënduese nuk u gjetën në rastin konkret, andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES
2022:145699, 03.07.2023



Gjyqtari

Bahri Salihu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 (tetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Divizionit të kundërvajtjes, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Data

10. 8. 2023
B. Salihu

